EE

IAWD International Association of Water Supply Companies in the Danube River Catchment Area

Danube Learning Partnership




# Efiçenca e Energjisë në Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

**FITOJNË** përvojë praktike në rritjen e efiçencës së energjisë

**MËSOJNË** nga praktikuesit e tjerë në sektor

**INFORMOHEN VAZHDIMISHT** rreth tendencave më të fundit në sektor

**PËRFITOJNË** nga përvojat rajonale dhe globale nga shoqëritë e tjera ujësjellës kanalizime

SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

SHUKOS
SHOQATA E UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMIT TË KOSOVËS

Ky program realizohet në bashkëpunim me Shoqatën Ujësjellës Kanalizime të Shqipërisë (SHUKALB) dhe Shoqatën e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS)

# Efiçenca e Energjisë në Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

**Njihuni me** studimet e fizibilitetit të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve - cilat janë objektivat dhe informacioni që nevojitet




**Mësoni rreth**
konsumit të energjisë në infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve




**Të kuptuarit** e nxitësit të intensitetit të energjisë




**Marrja e informacioneve** rreth teknikave dhe mjeteve të auditimit të energjisë së përdorur në sistemin e pompimit në terren dhe demonstrimi pajisjeve në kushte reale



**Përvetësimi i njohurive** rreth analizimit të energjisë së përdorur pas sistemeve të pompimit në terren dhe identifikimi i masave




**Të kuptuarit** e raportit të studimit të fizibilitetit dhe hartimi i një propozimi për modifikime




**Hartimi** i një strukture financiare të një projekti për përmirësimin e efiçencës së energjisë



# Efiçenca e Energjisë në Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

## Përshkrimi i programit dhe temat e trajtuara

Kostot e larta të energjisë shpesh kontribuojnë në shpenzime operimi të paqëndrueshme që ndikojnë drejtpërdrejtë shëndetin financiar të shoqërive ujësjellës kanalizime dhe përballueshmërinë e shërbimeve të tyre. Ky Program mbështet shoqëritë pjesëmarrëse në grumbullimin, auditimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje me përdorimin e energjisë dhe zhvillimin e programeve të investimit bazuar në ato të dhëna, për të mbështetur reduktimin e kostove të energjisë dhe rritjen e efiçencës së energjisë. Programi gjithashtu ndihmon në sigurimin e burimeve financiare për të plotësuar nevojat e investimeve për efiçencën e energjisë.

Programi është zhvilluar në nivel rajonal në bashkëpunim me Partnerin Teknik Econoler dhe do të jepet nga HUB-et kombëtare ose rajonale në gjuhën lokale. Ndërsa zhvillohet në mjediset e punës, programi është tepër praktik dhe ndërlidh perspektivën e operatorëve të pompave dhe menaxherëve të shoqërive ujësjellës kanalizime. Ai krijon mjete dhe teknika për shoqërinë ujësjellës kanalizime por edhe për nivelin qeverisës dhe siguron mbështetje afatgjatë për shoqëritë ujësjellës kanalizime nëpërmjet ekspertizës, programeve kompiuterike dhe pajisjeve.

### Instalimi i programit

Ky program është projektuar mbi bazën e parimit 'mëso përmes praktikës'. Përfshin një kombinim trajnimeve ballë-për-ballë, ku ofrohen mjete dhe teknika për adresimin e sfidave që hasen dhe aplikimin e tyre në praktikë, pasuar nga trajnimi në vendin e punës, ku shoqëritë që marrin pjesë i zbatojnë këto mjete dhe teknika në situatat e tyre specifike dhe krijojnë produkte konkrete (diagnostikë, plane veprimi, etj.). Ndiqen parimet e të mësuarit të kombinuar, që do të thotë trajnimi ballë-për-ballë shoqëruar me materiale mësimore ofruar brenda Akademisë D-LeaP.

Për më shumë informacion mbi konceptimin dhe projektimin e këtij programi, vizitoni **www.d-leap.org**!

### Objektivat

Si të kryejmë një auditim të energjisë?

Si të zhvillojmë një plan investimi për të adresuar çështjet e energjisë?

Si të gjejmë burimet e nevojshme për të kryer investime të efiçiencës së energjisë?

### HUB-et:

**SHUKALB**, Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë

**SHUKOS**, Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës

### Partner Teknik:

ECONOLER

### Kontakt:

**Arbana Kola**
Menaxhere e Trajnimeve dhe Zhvillimit Profesional
Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë
+355 69 7081664
arbana.kola@shukalb.al

**Olta Ceca**
Menaxhere e Programeve
Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë
+355 69 70 81 515
training@shukalb.al

Danube Learning Partnership

Danube Learning Partnership Secretariat
c/o IAWD Technical Secretariat
Praterstraße 31/17, A-1020 Vienna
office@d-leap.org
www.d-leap.org

The Danube Learning Partnership is supported by
IAWD DANUBE WATER PROGRAM
Smart policies, strong utilities, sustainable services